

Ky njoftim është për të ftuar gjithë fermëret e interesuar në Komunën e Hanit të Elezit për përkrahje në themelimin e aktiviteteve të reja ekonomike dhe përmirësimin e njohurive dhe aftësive të tyre biznesore në sektorin agro –pyjorë.

Nën skemën e Programit Laboratori për Aktivitete të Biznesit (LAB) për vitin 2016 kjo përkrahje financohet nga Titan Group Sharrcem shpk dhe ka për synim rritjen e nivelit të shfrytëzimit të potencialeve agro pyjore për të kontribuar në krijimin e vendeve të reja të punës përmes vetëpunësimit dhe krijimit të të ardhurave shtesë për neveojat e familjes dhe zgjerimin e bizneseve të themeluara.

*Ne ju inkurajojmë që të ndani këtë informatë me të gjithë ata që mund të jenë të interesuar për këtë mundësi.*

#### **Sektorët aktiv të cilët do të përkrahen për zgjerim:**

##### **1. Serra**

Objektivi: Përkrahja e themelimit të aktiviteteve të reja ekonomike për kultivim të perim kulturave dhe prodhim të fidaneve në serra.

Titulli: Furnizim me serra, farëra, fidanë dhe inpute tjera përcjellëse, dy serra të tipit “Bllok” me sipërfaqe 500 m<sup>2</sup> për kultivimin intensiv të perimeve.

##### **2. Mjedër**

Objektivi: Përkrahja e themelimit të aktiviteteve të reja ekonomike për prodhimin e frutave të imta – mjedër.

Titulli: Furnizim me fidane të mjedrës si dhe inpute tjera përcjellëse, mundësi për të përkrahur deri në tri sipërfaqe me nga 0,2 ha.

##### **3. Luleshtrydhe**

Objektivi : Përkrahja e themelimit të aktiviteteve të reja ekonomike për prodhim të frutave të imta – luleshtrydhe.

Titulli: Furnizim me fidane të luleshtrydhes si dhe inpute tjera përcjellëse, mundësi për të përkrahur deri në dy sipërfaqe me nga 0,2 ha.

##### **4. Vreshtari**

Objektivi : Përkrahja e themelimit të aktiviteteve të reja ekonomike, ngritja e pemishteve të rrushit të tryezës.

Titulli: Furnizim me fidane dhe inpute tjera përcjellëse, mundësi për të përkrahur deri në dy sipërfaqe me nga 0,2ha

#### **Sektorët e ri që do të përkrahen:**

##### **5. Shpeztari**

Objektivi : Investime në themelimin e pularive familjare semi intenzive për prodhimin e vezëve.

Titulli: Furnizim me pula vojse, ndërtimi i kabinave të drurit dhe pajisja me inpute tjera përcjellëse, mundësi për të përkrahur deri në pesë përfitues (përparsi në përkrahje do të kenë gratë e veja, mbajtëse të familjes).

Përkrahja do të zbatohet nga OJQ “LAB” në bashkëpunim me Drejtorinë për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural (BPZHR) dhe Kryetarët e Këshillave Lokal të Hanit të Elezit.

Aplikacionet duhet të dorëzohen më së largu deri me datë **15 Qershor 2016**, në orën 16:00.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në zyrat e LAB në adresën:

Adem Jashari p.n 71510 Hani i Elezit.

*Për çdo informatë në lidhje me shpalljen publike dhe zbatimin e tij mund të merren në zyrat e LAB-it.*

*Kopjet e udhëzuesit për plotësimin e aplikacionit dhe formularin mund ti merrni direkt në zyrën LAB-it*

*Aplikantët duhet të mbajnë nga një kopje të aplikacionit të dorëzuar dhe kopjet e dokumenteve të bashkangjitura.*

*Të gjitha aplikacionet duhet të dorëzohen në afatin e dhënë dhe sipas rregullave dhe kushteve të vendosura nga LAB.*